REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
SEKRETARIATI

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

**Komisioni i Arsimit**

Datë 24.06.2025

Lenda: **"PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË BASHKISË KAVAJË", "PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME USHQIM".**

**Analiza ligjore:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 57, pika 1, Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr.10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH" i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore", Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018, Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"; Kreu II, "Arsimi Parashkollor", Udhezimit nr.14 date 10.7.2023 "Per numrin e nxenesve per klase dhe ngarkesen mesimore te punonjesve arsimore", VKB Nr. 68 datë 23.12.2024, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025".

**Situata aktuale e funksionit:**

Referuar relacionit përmbledhës të përgatitur nga Agjencia e Arsimit Parashkollor, Bashkia Kavajë dërguar këshillit bashkiak, rezulton se:

Kërkesa në rritje të prindërve për shërbimin e drekës, ka bërë që fëmijët e zonës Golem dhe Luzi Vogël, të regjistrohen në kopshtet e qytetit Kavajë dhe në këtë mënyrë, kopshtet që e ofrojnë këtë shërbim, të jenë mbi kapacitet. Kjo për pasojë , ka sjellë shpenzime të paparashikuara për familjarët e zonës së Golemit dhe të Luzit të Vogël. Regjistrimet mbi kapacitet në qytet sjellin gjithashtu edhe probleme në efikasitetin e ulët gjatë procesit të edukimit dhe nxënies së fëmijës.

Planifikimet e mbështetura edhe në kërkesat me shkrim të prindërve të fëmijëvë, janë që të kthehet në kopsht me ushqim fillimisht njëri nga grupet dhe në vitin 2025 - 2026 edhe grupi tjetër në varësi të kërkesave të komunitetit.

Për të gjitha këto arsye, është e rëndësishme që kopshti Golem dhe kopshti Luzi Vogël pa ushqim, të mund të kthehet në kopsht me ushqim pasi i përmbushin të gjitha standartet infrastrukturore dhe në këtë mënyrë, plotësojmë kërkesat në rritje të banorëve të zonës.

| Nr | Indikatori | Shpërndarja gjeografike | Fakt Aktual |
|---|---|---|---|
| 1. | Numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo ditë kopshtin | Golem | 112 |
| 2. | Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht me ushqim | Golem | 50 |
| 3. | Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht pa ushqim | Golem | 62 |

| Nr | Indikatori | Shpërndarja gjeografike | Fakt Aktual |
|---|---|---|---|
| 1. | Numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo ditë kopshtin | Luzi Vogël | 52 |
| 2. | Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht me ushqim | Luzi Vogël | 25 |
| 3. | Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht pa ushqim | Luzi Vogël | 27 |

Për më sa sipër kërkohet:

1. Miratimi në Këshillin Bashkiak i planit dhe buxhetit për kthimin e kopshtit Golem, në kopsht me drekë;
2. Planifikimi i punës dhe kostove për kthimin e kopshtit Golem në kopsht me drekë;
3. Miratimi i planit dhe buxhetit, në Këshillin Bashkiak;
4. Hapja e procedurave të prokurimit publik dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik;
5. Punësimi i burimeve njerëzore të nevojshme;

- **Kopshti Golem**

  Paga për: 1 (një) kuzhinier/e,
  1 (një) ndihmës kuzhinier/e,
  1 (një) pjatalarëse,
  1 (një) roje objekti
  3 (tre) mësuese / edukatore.

- **Kopshti Luzi Vogël**

  Paga për: 1 (një) kuzhinier/e,
  1 (një) ndihmës kuzhinier/e (pjatalarëse) ,
  1 (një) sanitare
  1 (një) roje objekti

**Impakti Financiar:**

Fonde nga buxheti i bashkisë Kavajë.

**Drejtoria/Sektori pergjegjes:**

Agjencia e Arsimit Parashkollor, Bashkia Kavajë

**Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria përkatëse dhe Këshilli Bashkiak Kavajë

**Impakti social/grupet qe preken:**

Fëmijët banorët në Njësitë Administrative të Luzi Vogël dhe Golem

**A eshte objekt konsultimi:**

Jo

Komisioni i perhershem i Arsimit u mblodhë më datë 24.05.2025 dhe shqyrtoi projekt-vendimin **"PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË BASHKISË KAVAJË", "PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME USHQIM ",** relacionin dhe dokumentat shoqerues te tij.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozoje Keshillit bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit ne mbledhjen e Keshillit per vleresimin e metejshem dhe per shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit te projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

______________________________

**Anëtarët e Komisionit**

| | |
|---|---|
| Valbona Mustafa | Kryetar |
| Meleqe Kazazi | Nen/Kryetar |
| Shqipe Baulja | Anetar |
| Rovina Aliaj | Anetar |
| Enea Stefa | Anetar |

Date: 24.06.2025